




Si ndikojnë politikat globale kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në punën e Organizatave Jo-Qeveritare?



Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Çka është Task Forca e Veprimit Financiar (Financial Action Taskforce - FATF)? ¹ | 5 |
| Çka është Rekomandimi 8 i FATF-së për Organizatat Jo-Qeveritare? | 6 |
| Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare në Kosovë | 10 |
| Trajtimi i OJQ-ve në Kosovë si Subjekte Raportuese | 11 |
| Identifikimi i “Pronarit Përfitues” tek OJQ-të | 13 |
| Si të mbrohemi nga abuzimi i mundshëm për financim të terrorizmit? | 15 |



Norwegian Ministry of Foreign Affairs

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Programit Global "Lufta kundër flukseve të paligjshme financiare" i zbatuar nga GIZ dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Platforma CiviKos dhe nuk pasqyron pikëpamjet e GIZ, Ministrisë Federale Gjermane të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik ose të Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze.

Ky broshurë është përgatitur nga Platforma CiviKos, me mbështetje të organizatës Human Security Collective dhe financuar nga GIZ. Broshura përmban informacione se si Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) krijon rekomandimet, dhe rrjedhimisht politikat globale, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe si këto ndikojnë punën e Organizatave Jo-Qeveritare (OJQ).



Sipas FATF-së, flukset e parave brenda dhe përmes OJQ-ve shihen si një burim potencial për financimin e terrorizmit. Prandaj, FATF kërkon nga qeveritë të mbrojnë sektorin e OJQ-ve nga abuzimi ose keqpërdorimi për krime financiar, nëpërmjet zbatimit të një regjimi rregullator që trajton në mënyrë adekuate dhe efektive rreziqet e financimit të terrorizmit në këtë sektor. Kjo është ri-vënë në pah pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në SHBA.

Në Kosovë OJQ-të vazhdojnë të mbesin subjekte raportuese në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, si dhe në vitet e fundit janë ballafaquar me shumë probleme në qasjen në shërbime bankare si: **mbyllja e llogarive bankare pa paralajmërim, kërkesat që themeluesit e OJQ-së të jenë prezent në hapje dhe mirëmbajtje të llogarisë bankare, rritja e shumave për pagesë për mirëmbajtje të llogarive vetëm për OJQ-të, (dhe jo per bizneset p.sh) etj.**



Çka është Task Forca e Veprimit Financiar (Financial Action Taskforce - FATF)?¹

Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) është themeluar në vitin 1989 dhe e ka selinë në Paris dhe udhëheq aksionin global për të trajtuar pastrimin e parave, dhe financimin e terrorizmit. Ky organ, i përbërë prej 39 anëtarësh, vendos standarde ndërkombëtare për të siguruar që autoritetet kombëtare të mund të ndjekin efektivisht fondet e paligjshme të lidhura me trafikun e drogës, tregtinë e paligjshme të armëve, mashtrimin kibernetik dhe krime të tjera të rënda.

Duke pasur parasysh, përveç 39 anëtarëve, pothuajse të gjitha vendet e tjera janë anëtarë të Task Forcës së Veprimit Financiar dhe Organeve Rajonale të stilit FATF.

Kosova, për shembull, është pjesë e përgjegjësisë së Grupit Kundër Pastrimit të Parave të Këshillit të Evropës (MONEYVAL) me seli në Strasburg, Francë (Këshilli i Evropës)².



FATF hulumton se si pastrohen paratë dhe financohet terrorizmi, promovon standardet globale për të zbutur rreziqet dhe vlerëson nëse vendet po ndërmarrin veprime efektive. Në total, më shumë se 200 vende dhe juridiksione janë zotuar të zbatojnë standardet e FATF-së si pjesë e një reagimi të koordinuar global për parandalimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit. Vendet dhe juridiksionet vlerësohen me ndihmën e nëntë organizatave anëtare të asociuara të FATF-së dhe partnerëve të tjerë global, FMN-së dhe Bankës Botërore. Organizatat anëtare (organet rajonale të stilit FATF) dhe partnerë të tjerë globalë, duke përfshirë FMN-në dhe Bankën Botërore. Janë 40 Rekomandime që përbëjnë Standardet e FATF-së dhe qeveritë kombëtare duhet t'i zbatojnë këto standarde nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve në juridiksionet e tyre.

Organi vendimmarrës i FATF-së, Asambleja, mbledhet tre herë në vit dhe kërkon llogari nga vendet nëse nuk respektojnë standardet. Nëse një vend në mënyrë të përsëritur dështon të zbatojë standardet e FATF-së, atëherë ai mund të quhet "juridiksion nën monitorim të shtuar" ose "juridiksion me rrezik të lartë". Këto shpesh quhen nga jashtë si "lista gri dhe e zezë".

¹ <https://www.fatf-gafi.org/en/the-fatf.html>

² <https://www.coe.int/en/web/civil-society/money-laundering>


Çka është Rekomandimi 8 i FATF-së për Organizatat Jo-Qeveritare?


Nga 40 rekomandimet e FATF-së, Rekomandimi 8 i dedikohet vetëm Organizatave Jo-Qeveritare. Ky rekomandim specifikon një sërë kërkesash për të rregulluar sektorin jofitimprurës në tërësi për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe. Flukset e parave brenda dhe përmes OJQ-ve shihen në standardet e FATF-së si një burim potencial për financimin e terrorizmit. Qeverive u kërkohet të mbrojnë sektorin e OJQ-ve nga abuzimi ose keqpërdorimi për qëllime të krimit financiar nëpërmjet zbatimit të një regjimi rregullator që trajton në mënyrë adekuate dhe efektive rreziqet e financimit të terrorizmit në këtë sektor.


Rekomandimi 8 u rishikua në vitin 2016, pas lobimit dhe avokimit të vazhdueshëm të Koalicionit Global të OJF-ve³ mbi FATF, duke rezultuar në heqjen e karakterizimit prej kohësh të organizatave jofitimprurëse si “veçanërisht të cenueshme” ndaj abuzimit për terrorizëm. Gjuha e mëparshme çoi në mbi-rregullim dhe kufizime të papërshtatshme ndaj Organizatave Jo-Qeveritare, duke penguar punën e tyre legjitime dhe thelbësore në mbarë botën.


Sipas rekomandimeve të FATF, shtetet duhet të ndërmarrin veprime edukuese për të rritur ndërgjegjësimin e OJQ-ve në këtë fushë.

Disa nga veprimet që shtetet duhet t'i ndërmarrin janë⁴:

 Të kryejnë një vlerësimin të rrezikut për sektorin e OJQ-ve që identifikon abuzimin e mundshëm nga terrorizmi;

 Të bëjnë rishikimin e ligjeve aktuale, rregulloreve dhe programeve të vetë-rregullimit për të parë nëse ato adresojnë rreziqet e identifikuar;

 Të sigurohen që masat e propozuara janë në proporcion me rrezikun e identifikuar dhe nuk kufizojnë operimin e OJQ-ve;

 Të krijojnë rezultate që janë konsistente me obligimet ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Të gjitha këto katër veprime duhet të zbatohen në dialog me sektorin e shoqërisë civile.

³ <https://fatfplatform.org/>

⁴ https://ufr.gov.mk/wp-content/uploads/2020/05/KONEKT-Prirachnik-za-SPP-FT_ENG.pdf

Riformulimi i Rekomandimit 8

Formulimi i ri i Rekomandimit 8 pranoi qartë se jo të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare janë rrezik dhe i udhëzoi vendet të ndërmarrin **një qasje të bazuar në rrezik** kur shqyrtojnë masat e financimit të terrorizmit.



FATF u bën thirrje vendeve që të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet e PP/FT me të cilat përballen përmes një Procesi Kombëtar të Vlerësimit të Riskut. FATF u bën thirrje vendeve **të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet e PP/TF** me të cilat përballen dhe thekson se vendet duhet të caktojnë gjithashtu një autoritet ose mekanizëm për të koordinuar veprimet e vlerësimit të rrezikut. Qëllimi është të sigurohet që vendet mund të zbusin rreziqet e tyre të PP/FT në mënyrë efektive dhe vlerësimi i rrezikut synon qartë të shërbejë si bazë për një aplikim të qasjes së bazuar në rrezik, d.m.th. të sigurojë që masat të jenë proporcionale me rreziqet e identifikuar.

Parimet e një qasjeje të bazuar në rrezik janë:



Bazimi në prova;



Përfshirja e OJQ-ve në proces;



Proporcionaliteti apo veprime konkrete proporcionale me rreziqet e identifikuar).

Qasje e bazuar në rrezik

FATF thekson zbatimin e një qasjeje të bazuar në rrezik për rregullimin e sektorit në mënyrë që aktivitetet legjitime të Organizatave Jo-Qeveritare të mos ndikohen. Megjithatë, zbatimi i standardeve në nivel kombëtar nuk ka qenë gjithmonë i bazuar në rrezik ose proporcional, por qasje që çon në pasoja të padëshiruara për sektorin, duke përfshirë vështirësitë operacionale që ndikojnë në lirinë e asociimit dhe të shprehjes, si dhe çështjet në aksesin financiar.



Në vend që 'të synojnë vetëm OJQ-të që janë në rrezik' dhe 'më pas të marrin masa të përshtatshme dhe proporcionale legjislative ose të tjera për të ndihmuar në zbutjen e këtij rreziku,' tendenca e shumë qeverive është të mbirregullojnë sektorin e OJQ-ve dhe të kenë një qasje unike për të gjitha OJQ-të, e jo një **qasje e bazuar në rrezik**. Kjo nuk është efektive as për qeverinë për sa i përket mandatit të saj për ligjet PP/FT dhe as për OJQ-të për sa i përket veprimtarisë së tyre të përditshme.



OJQ-të në mbarë botën janë përballur me kufizime operacionale dhe ligjore. Kjo ka ndikuar negativisht në aftësitë e OJQ-ve për të zbatuar aktivitete dhe për të mbrojtur nevojat e përfituesve, veçanërisht në zonat e krizës apo konfliktit.



Për të qenë në përputhje me standardet e FATF-së, shtetet tani nuk mund të miratojnë më rregullore të gjera që prekin të gjitha OJQ-të duke pretenduar se i gjithë sektori është në rrezik.



Në vend të kësaj, shtetet duhet të përdorin një proces të vlerësimit të rrezikut për të identifikuar OJQ-të specifike në rrezik dhe pastaj të marrin masat e duhura legjislative, apo masa tjera, proporcionale me rrezikun dhe që synojnë vetëm OJQ-të që gjenden në rrezik. Kjo është gjithashtu baza e metodologjisë së re të vlerësimit të FATF/MONEYVAL që rishikon nëse shtetet kanë ndërmarre qasjen e bazuar në rrezik ndaj OJQ-ve.

Shembuj të mbirregullimit të sektorit të OJQ-ve



Kufizime në themelimin e organizatave: Futja e kërkesave të rënda për licencim dhe qeverisje;



Kufizime në aftësinë për të avokuar për ndryshim: Kufizimi i aftësisë së OJQ-ve për t'u shoqëruar dhe etiketimi i mbrojtësve të drejtave të njeriut si terroristë.



Barrierat ligjore që pengojnë aftësinë e OJF-ve për t'u qasur në burime financiare të huaja në formën e granteve dhe donacioneve të ndryshme.



Kërkesa të rënda për raportim.



Restriksione nga bankat komerciale në shërbime bankare për OJQ-të.

Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare në Kosovë

Liria e Asociimit në Kosovë është liri e garantuar me Kushtetutë si dhe e rregulluar me Ligji Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare⁵.

Sipas këtij Ligji, i miratuar në Prill 2019, njihen tri forma të regjistrimit:

Shoqata

Fondacione

Institute

Organi më i lartë vendimmarrës në OJQ, varësisht nga forma e regjistrimit është:



Për Shoqata
Kuvendi i Anëtareve

Themeluesit e organizatës nuk kanë rol udhëheqës në organizatë, përveç në raste kur personat e njëjtë që e kanë themeluar OJQ-në mbajnë pozitën e anëtarit të Kuvendit ose Bordit të organizatës.

Ligji për Liri të Asociimit obligon të gjitha OJQ-të që transaksionet e tyre financiare t'i kryejnë përmes institucioneve të licencuara bankare.



Për Fondacione dhe Institute
Bordi i Organizatës

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>

Trajtimi i OJQ-ve në Kosovë si Subjekte Raportuese

Në Kosovë OJQ-të vazhdojnë të trajtohen si subjekte raportuese me Organizatat Jo-Qeveritare në Kosovë janë subjekte raportuese sipas **Ligjin nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit⁶**. Si subjekte raportuese OJQ-të obligohen të marrin masa, dhe të vendosin kontrolle për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 29: Detyrimet specifike të OJQ-ve

1. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-ve kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga BQK-ja, në llogarinë bankare të hapur në emër të OJQ-së, me përjashtim të asaj që është paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.

2. OJQ-të mund të:

2.1. pranojnë kontribute në para të gatshme në vlerën që nuk tejkalon vlerën prej pesëqind (500) euro apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme. Vlera e përgjithshme e kontributit të pranuar sipas këtij paragrafi gjatë vitit nuk tejkalon vlerën prej njëmijë (1.000) euro;

2.2. paguajnë/japin një marrësi të vetëm para të gatshme që nuk tejkalon vlerën prej pesëqind (500) euro apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, brenda një (1) dite të vetme. Vlera e përgjithshme e pagesave sipas këtij paragrafi gjatë vitit nuk duhet të tejkalojë vlerën prej pesëmijë (5.000) euro.

3. OJQ-të ruajnë të dhënat financiare/librat e kontabilitetit të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Këto të dhëna identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, si dhe do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. Dokumentet për të dhënat financiare ruhen pesë (5) vite dhe janë në dispozicion sipas kërkesës së NjIF-K-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

4. OJQ-të i raportojnë NjIF-K, në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit 1.1. të nenit 26 të këtij ligji, të gjitha aktet apo transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.

⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>



5. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me Ligjin përkatës për Lirinë e Asociimit në GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 18 / 15 QERSHOR 2016, PRISHTINË 31 Ligji Nr. 05/L -096 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT Organizatat Joqeveritare, OJQ-ja në raport shpalosë edhe detajet e informatat të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni.

6. Pavarësisht nga cilado dispozitë tjetër ligjore, raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, i vihen në dispozicion NjIF-K me rastin e paraqitjes së kërkesës.

7. Përfaqësuesi i autorizuar sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare parimisht është zyrtar i pajtueshmërisë dhe person kontaktues me NjIF-K, përveç nëse OJQ nuk e përcakton ndryshe me vendim me shkrim ndonjë drejtorë, zyrtarë, punonjës tjetër të OJQ-së dhe njofton zyrtarisht NjIF-K. Përfaqësuesi i autorizuar i cili përgatit ose përcjell raporte në pajtim me këtë ligj është i detyruar nga dispozitat e paragrafit 4. të nenit 26 të këtij ligji.

8. Në përputhje me detyrimet e tyre si subjekte raportuese sipas këtij ligji, anëtarët e Bordit dhe stafi me përgjegjësi në menaxhimin e OJQ-së sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, marrin masa të duhura për të siguruar që OJQ-të nuk do të shfrytëzohen për pastrimin e parave ose si kanale të shpërndarjes së fondeve ose burimeve tek individët apo subjektet e lidhura me grupet ose organizatat terroriste.

9. NjIF-K dhe autoriteti mbikëqyrës sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikat, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji, siç janë të zbatueshme për OJQ në përputhje me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji

Identifikimi i “Pronarit Përfitues” tek OJQ-të

Gjithnjë e më shumë shtetet janë duke e imponuar kërkesën për identifikimin e pronarit përfitues edhe te OJQ-të, megjithëse, OJQ-të themelohen shumë ndryshe nga entitetet tjera fitimprurëse. Parimi “për jo përfitim” që aplikohet te OJQ-të, i obligon ato të përdorin të ardhurat e tyre për realizim të misionit dhe objektivave të tyre, dhe jo t’i shpërndajnë ato tek udhëheqësit, aksionarët apo anëtarët e organizatës. Prandaj, duke marrë parasysh natyrën e funksionimit, OJQ-të nuk kanë pronar përfitues në parim. Megjithatë, çdo OJQ, pavarësisht mënyrës së regjistrimit ka një strukturë kontrolluese, që janë përgjegjës për funksionimin e organizatës dhe kjo strukturë udhëheqëse duhet të jetë në dispozicion për autoritetet shtetërore. Është kërkesë minimale ligjore që çdo organizatë të ketë një përfaqësues të autorizuar dhe një strukturë vendimmarrëse, siç është Kuvendi i Anëtarëve për Shoqata, apo Bordi për Fondacione dhe Institute. Kjo çështje është gjithashtu e rregulluar edhe me Nenin 12 të Ligjit për Liri të Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare në Kosovë.



Neni 12. Parimi për jo përfitim

1. OJQ nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person.
2. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e OJQ-së përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën.
3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e OJQ-së nuk përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donatorë, përveç pagesës për personat që kryejnë punë për organizatën.

Edhe pse në Kosovë me Ligjin Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare, personi i autorizuar është përgjegjës për hapje, dhe mirëmbajtje të llogarisë bankare dhe ka autorizim për të përfaqësuar personin juridik, në **UDHËZIM ADMINISTRATIV MF (NjIF-K) 2021 PËR PRONARIN PËRFITUES PËR SUBJEKTET RAPORTUESE**⁷ Identifikimi i pronarit përfitues tek OJQ-të është e rregulluar me Nenin 8:

Neni 8. Identifikimi i pronarëve përfitues të OJQ-të


1. Për Organizata Jo Qeveritare të themeluara sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo Qeveritare në Kosovë, subjektet raportuese me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të pronarit përfitues do të zbatojnë masa të kujdesit të duhur për identifikimin e strukturës drejtuese të OJQ-së, kryesuesin e kuvendit të anëtarëve (kur është e aplikueshme), anëtarët e bordit drejtues dhe manxhmentit ekzekutiv.
2. Përfaqësuesi i autorizuar sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo Qeveritare në Kosovë, është person përgjegjës për ofrimin e informatave sipas paragrafit 1 të këtij neni.



⁷ https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/07/UDHEZIM_ADMINISTRATIV_MF_NjIF-K_Nr_01-2021.pdf

Si të mbrohemi nga abuzimi i mundshëm për financim të terrorizmit?

Në mënyrë që OJQ-të të mbrohen nga abuzimi i mundshëm për financim të terrorizmit, rekomandohet që OJQ-të të ndjekin parimet bazë të mirëqeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies siç janë:



Misioni dhe Vlerat - Qëndroni tek misioni që e keni caktuar, dhe promovoni vlerat e demokracisë, barazisë dhe transparencës.

Vendimmarrja në Organizatë - Organizata të ketë strukturë të qartë vendimmarrëse ku përfshihen më shumë se një person në procese vendimmarrëse. Të promovohen parimet e demokracisë, mos-diskriminimit në baza gjinore, etnike fetare etj.



Transparenca dhe Llogaridhënia Financiare - Organizatat rekomandohet që të publikojnë burimet e tyre financiare si dhe raportet e tyre financiare vjetore për gjithë publikun.

Politika të Qarta Kundër Korrupsionit - Organizata rekomandohet të ketë politika të qarta të grumbullimit të fondeve, ku adresojnë në mënyrë të qartë parandalimin e korrupsionit, konfliktin e interesit, si dhe ka mekanizma të qartë të raportimit të keqpërdorimeve të mundshme.



www.civikos.net
info@civikos.net